Asambleja
01.Nr.I
Deçan,dt.31.01.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e I-rë të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.31.01.2020.
Në mbledhje ishin prezent:26 anëtarë të asamblesë, disa drejtor të drejtorive komunale, drejtori i QKMF-së, OSBE, KFOR, OJQ, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020,
3. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2020,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores Komunale për transparencë,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2020,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integrime Evropiane për vitin 2020,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Statutit të Ansamblit artistik të këngëve dhe valleve;
8. Marrja e vendimit për rritjen e buxhetit komunal të vitit 2019 nga të hyrat vetanake të vitit 2019;
9. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e I-rë të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 26 asambleist (mungon Besjana Ukëhaxhaj).
Kryesuesi- njofton se në KPF është debatuar çështja e shërbimeve në QKMF dhe si rezultat i kësaj me rekomandim te KPF-se ka ardhe qe te debatohet si pike e veçantë sot ne kuvend, ne vazhdim e qiti ne votim rekomandimin e KPF-se qe te debatohet kjo qeshtje si pike e veqante, antaret e kuvendit e miratojnë njëzëri.
Kryesuesi- e prezentoj rendin e punës të propozuar me ftesë, antaret e kuvendit e miratojnë njëzëri.
Drejtori i QKMF-së, Selman Berisha, ka kërkuar qe pika e tyre te debatohet e para, per te cilën kerkese eshte pajtuar kuvendi.
-Debat rreth organizimit te punës dhe shërbimeve qe ofrohen ne QKMF.
Drejtori i drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale, Musa Berisha fillimisht pershendete pjesëmarrësit ne mbledhje dhe i falënderon Kuvendin per ftesën qe ju kane bere , sepse vetëm kështu sqarohet e vërteta ka thene ai, pastaj ai ka shtuar se QKMF punën e vet e kryen sipas ligjeve ne fuqi.
Selmon Berisha, Drejtor i QKMF-se- pas përshëndetjes thot se jam i lumtur qe me keni ftuar këtu ne kete interpelance, sipas ligjit shëndetësia organizohet ne tri nivele dhe si QKMF ne harmoni me ligjin ofrojmë shërbime primare shendetsore 24 ore ne dite, ne vazhdim ai ka referuar per punën qe behet aty si dhe sfidat me te cilat perballen gjate kryerjes se këtyre punëve.
Fatmir Kurmehaj- pyet, se çka përfshinë shërbimi primare shendetsore.
Drejtori QKMF-se – sqaron rreth shërbimit primar shëndetësorë, ai thot se te gjitha shërbimet kryhen me dy ndërrime deri ne ora 10 e natës, ai sqaron ne hollësi per te gjitha shërbimet qe

kryhen si dhe sa eshte numri i shërbimeve, problemin ka thene ai e kemi me ordinanca private dhe kerkoj nga ju si kuvend qe te ndërmerrni hapa konkret per kontroll te ordinancave private.
Ilir Ferizaj- kërkon sqarim rreth rastit qe ka dale ne media.
Dr.Selmona Berisha- sqaron se gazetari i KTV-se ka kërkuar qe te bene nje raport pastaj e ka degraduar lajmin.
Kryesuesi i mbledhjes Dr.Haki Shehaj- nga ana profesionale sqaron si behet organizimi i punëve ne QKMF, ai thot se ligji i ka dëmtuar komunat e vogla qe nuk kane qendra spitalore brenda vetes, mirëpo ne jemi te interesuar qe te bëjmë zgjedhje per qytetaret tonë. Dhe kërkesa e jone ne kete rast si kuvend eshte qe ju si QKMF te bëni zgjidhje ne menyre qe mos te ankohen qytetaret.
Drejtori i QKMF-se thot se kryesuesi e sqaroj shum mire procedurën si kryhen punët ne QKMF, pastaj prap sqaron se si trajtohen pacienet te cilët drejtohen per te marre shërbime ne kete qendër.
Florim Mataj- pyet se a jemi te zote ne si institucion qe tia ofrojme qytetarit shërbimet qe ka nevoje.
Dr.Selmon Berisha- qsaron per shërbimet qe kryhen dhe numrin e tyre .
Albana Avdiu-kerkon sqarim rreth procedurave kur pacientet marrin shërbime nga nje institucion tjetër dhe kur vjen ne QKMF nuk merr shërbim pa u regjistru si pacient aty.
Shkelzen Hadergjonaj- thot se ka ndryshime per te mire ne QKMF pastaj pyet se per cilët profile te mjekëve ka mungese ne QKMF.
Dr.Selmon Berisha – pergjigjet se ne shërbimin primar nuk ka mungesa.
Mon Selmonaj- e falënderon doktorin per sqarimet e dhëna pastaj shtron pyetjen:nëse pacienti pas vizitës ne QKMF shkon te nje specialist tjetër a ka mandej te drejte me ardhe ne QKMF me i regjistru barnat dhe me i marre shërbimet.
Doktor Selmoni- pergjigjet, po, pastaj hollsishte sqaron procedurën si kryhe këto pune, ai thot se nuk ka pacient qe pret ma shum se 10 minuta ne QKMF per te marre shërbime, pastaj kërkon nga kryesuesi qe te formohen grupe punuese dhe te shkojnë ne QKMF per vizite, ai thot se per çdo vit e bene raportin e punës ku ceket per çdo punëtor sa pune ka krye.
Ilir Ferizaj- thot se kam kritike per drejtorin e Drejtorisë për Shëndetësi që nuk vjen kurrë ne mbledhje dhe sot pi shof ate per here te pare këtu.
Shkelqesa Hadergjonaj- pyet cilat analiza kryhen ne QKMF dhe a ka mundësi qe te kryhet këtu edhe analiza e përcaktimit te grupit te gjakut.
Drejtori- pergjigjet se kryhen te gjitha analizat.
Agnesa Vokshi tregon per nje ngjarje qe ka ndodhe ne QKMF.
Valdet Nuraj- thot se infuzioni eshte dhen ne QKMF gjithmonë pastaj shtron pyetjen se a ipet infuzioni pas orës 10 te natës, dhe deri ku kane shkuar punët me ndërtimin e objektit te emergjencës.
Drejtori i QKMF-se – pergjigjet se ndërtimi i objektit te emergjencës eshte donacion i Ministrise ku parashihet kryerja e punimeve ne afat prej tre viteve dhe dy vite kane shkuar dhe ka mbete tash vetëm edhe nje vit qe te permbyllet ky projekt, ndërsa infuzioni ne QKMF thot ai ipet ne çdo kohe edhe pas orës 10 te natës per te gjithë pacientet qe vertete kane nevoje.
Drejtori i drejtorisë per Shendetsi- sqaron se ka munguar ne mbledhjet e kuvendit sepse ka pase probleme shendetsore, ai ka thene se shërbimet ne QKMF do te kryhen ne çdo kohe ne menyre perfektë sipas nevojave te qytetarve, ndërsa lidhur me rastin qe u be lajm ne media nga gazetaret ka qene vetëm nje keqkuptim.
Albesa Cacaj- shqetësim mi eshte se sa here qe vi ne amulante me duhet te pres sepse nuk i gjej mjekët aty, pastaj pyet, se a japin mjeket llogari per përshkrimin e antibiotikeve .
Drejtori- pergjigjet se jemi duke i mbikqyre përmes koordinatorit per cilsi.
Milazim Mushkolaj- thot se krejte kjo ka qene nje dezinformate dhe ka ardhe qeshtja deri këtu qe me i ftu te dy drejtorët per te dhene sqarim , mirëpo sqarimi u dha dhe ne i falënderojmë drejtoret per kete.

Kryesuesi- ka thene se me kaq e mbyllim kete teme, meqenëse u shtruan mjaft qeshtje këtu ne lidhje me punët qe kryhen ne QKMF dhe u dhanë sqarime te mjaftueshme prandaj ne i falënderojmë drejtorin e drejtorisë per shendetsi dhe drejtorin e QKMF-se per sqarimet e dhëna.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga bledhja e kaluar.
-Miratohet njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2020,
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj sqaron se ne planin e prezentuar janë përfshi vetëm temat obligative, pastaj e ka hape debatin ne Kuvend, mirëpo meqenëse nuk kishte debat per te, ai e qiti ne votim, antaret e kuvendit e miratuan njëzëri.
III. Marrja e Vendimit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta dhe mbledhjeve publike të Kuvendit dhe të KPF-së për vitin 2020.
Propozimi per mbajtjen e mbledhjeve te kuevendit dhe te KPF-se miratohet njëzëri pa debat.
IV. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Rregullores Komunale për transparencë
Kryesuesi- e ka prezentu projekt rregulloren pastaj sqaron se te gjitha procedurat ligjore te shqyrtimit janë permbushe.
Mon Selmonaj- kërkon sqarim te neni 24 pika 3.4 dhe 3.5 dhe pyet se a janë bere ndryshimet te neni 25 pika.
Yllarta Thaqi- sqaron se janë bere ndryshimet.
Kryesuesi- e qiti ne votim, ataret e kuvendit njëzëri e miratojnë Rregulloren komunale per transparence.
V. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Komitetit të Komuniteteve për vitin 2020.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj ka shtuar se plani eshte mire i pergaditur, ne vazhdim e hapi debatin ne kuvend, mirëpo meqenëse nuk kishte diskutim rreth tij ai e qiti ne votim, antaret e kuvendit e miratuan njëzëri ate.
VI. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së Zyrës për komunitete dhe Kthim dhe Integrime Evropiane për vitin 2020.
Edhe ky plan miratohet njëzëri ne kuvend pa debat.
VII. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-Statutit të Ansamblit artistik të këngëve dhe valleve.
Kryesuesi- e prezentoj piken pastaj ka shtuar se edhe ky projekt statut i ka kaluar procedurat ligjore te shqyrtimit, pastaj e hapi debatin rreth tij.
Valdet Nuraj- thot se kerkun nuk e pashe fjalën festival sepse donacionet ipen per festivale jo per koncerte, te neni 13 me kënd negociohet, pika 11. 3, ku duhet te dërgohen mjetet per ti ndihmuar.
Milazim Mushkolaj- te neni 4 kerkon qe te rregullohen numrat e paragrafëve, neni 12 pika 3 duhet te specifikohet, te neni 21 duhet te specifikohet ne cilën kohe.
Drejtoresha e drejtorisë per Kulture Rini dhe Sporte- pergjigjet se neni 12 pika 3 eshte ndryshuar me vendimin tuaj.
(Sqarim: pas konsultimit te ligjit eshte konstatuar se donacionet ipen per koncerte e jo pe festivale sepse kështu eshte e rregulluar me ligj, prandaj nuk ka nevoje per ndryshime ne reegullore.)
Kryesuesi- e qiti ne votim, antaret e kuvendit e miratojnë njëzëri Statutin e Ansamblit te këngëve dhe valleve.
VIII. Marrja e vendimit për rritjen e buxhetit komunal të vitit 2019 nga të hyrat vetanake të vitit 2019.
Kryesuesi- e ka prezentu piken, pastaj ka sqaruar se kërkohet te merret vendim per rritje te buxhetit te vitit 2019 per arsye se janë inkasuar te hura vetanake më shum se kane qene te planifikuara ne shumen prej 10.584.53 €, ne vazhdim e hapi debatin rreth kësaj pike meqenëse nuk kishte diskutime ai e qiti ne votim, antaret e kuvendit e miratuan njëzëri ate.
Me kete vendim Rritet buxheti i Komunës së Deçanit nga të hyrat vetanake të vitit 2019, në shumën prej 10.584,53 €, dhe orientohen në kodin buxhetor 631-21-17515-130-0112 apo Drejtoria për Buxhet dhe Financa ne kategorinë Mallra dhe Sherbime,dhe nga rritja prej 10.584,53 € shuma e planifikuar e të hyrave vetanake te vitit 2019 i cili ka qenë 670,403.00 €, rritet dhe bëhet 680,987.53 €.

Kryesuesi- e prezentoj edhe rekomandimin e KPF-se per angazhimin e 10 puntorve me kontrate ne vepër ne drejtorinë per buxhet dhe financa dhe 4 puntor ne drejtorinë per urbanizëm, ne vazhdim ai e hapi debatin , meqenëse nuk pati debat ai e qiti ne votim kerkesen e cila ne kuvend ka ardhe si rekomandim i KPF-se, antaret e kuvendit emiratojne njëzëri.
Merret Vendimi për angazhimin 10+4 puntorë me kontratë"Marrëveshje për shërbime të veçanta", të cilët 10 prej tyre do të punojnë në teren si Regjistrues të objekteve në kuadër të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa-Zyra e Tatimit në pronë, ndërsa 4 punëtorë me kontratë"Marrëveshje për shërbime të veçanta"do të punojnë në kuadër të Drejtoratit për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, si Ekspert për legalizim të objekteve pa leje.
XI.Të ndryshme.
Mon Selmonaj- pyet deri ku kane shkuar punët per dhënien e Eco Tregut ne shfrytëzim.
Rifat Stojkaj- sqaron se kemi qene ne procedurat e vlersimit te ligjshmërisë nga Ministria dhe do te vazhdojmë menjëherë pas kryerjes se këtyre procedurave.
Lirije Zukaj- kërkon sqarim per qeshtjen e ngritur me herët në Kuvend per te cilat nuk na eshte përgjigjur askush.
Ilir Ferizaj-kerkon sqarim per peticionin e fshatit Lluke lidhur me ndërtimin e nje gurthyesi.
Rifat Stojkaj- sqaron se kjo qeshtje eshte debatuar ne mbledhje te bordit dhe i kane dhene afat 10 dite atij per ti krye ato pune.
Shkelzen Hadergjonaj-kerkon sqarim deri ku kanë shku punët rreth zgjedhjes se Keshillave te fshatrave per te cilat eshte formu vitin e kaluar këtu ne kuvend edhe komisioni i posaqem.
Drejtori i drejtorisë per administrate, Jashar Dobraj- sqaron se vitin e kaluar nuk kemi mundur ta zbatojmë ate vendim sepse eshte dashtë te ndryshohet edhe rregullorja, poashtu ai vit ka qene edhe vit i zgjedhjeve dhe e kemi pa ma te arsyeshme qe te shtyhet kjo qeshtje dhe tash fillimisht do te miratohet rregullorja pastaj do te vazhdojmë me zgjedhjen e këshillave lokale te fshatrave.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:
Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj

Asambleja
01.Nr.II
Deçan,dt.02.03.2020

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të të rregullt të Asamblesë Komunale , me dt.02.03.2020.
Në mbledhje ishin prezent:22 anëtarë të asamblesë, Kryetari i Komunës, disa drejtor të drejtorive komunale, OSBE, OJQ, mediat.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi kryesuesi i Kuvendit, zotëri Haki Shehaj.
Për mbledhje ishte propozuar ky rend pune:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Marrja e vendimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2019 në vitin 2020,
3. Marrja e vendimit për lejimin e mjeteve buxhetore për aktivitete të Komunës dhe data me rëndësi,
4. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për Shërbime Publike,
5. Shqyrtimi i projekt- rregullores Për Lartësinë e Taksave, Ngarkesave,Tarifave dhe Gjobave Komunale,
6. Shqyrtimi i Planit Zhvillimor Komunal,
7. Shqyrtimi i Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Deçanit 2019-2022,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi e hapi mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit duke i përshëndetë pjesëmarrësit, verifikoj pjesëmarrjen e delegatëve dhe konstatoj se në mbledhje janë prezent 22 asambleist (mungojnë:Mustafë Selmanaj, Albane Avdiu, Besjana Ukëhaxhaj, Erblina Tahiraj, Natyra Kuçi).
Kryesuesi- njofton se Fatmir Kurmehaj ka dhënë dorëheqje nga pozita e antarit të Kuvendit dhe në vend të tij sipas radhës, në Kuvend ka ardhë Shkelqim Haxhnikaj nga i njëjti subjekt politik, Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK.Në vazhdim kryesuesi e fton antarin e ri, Shkelqim Haxhnikaj që të bënë dhënien e betimit solemn sipas procedurave të parapara ligjore.Shkelqim Haxhnikaj bënë betimin solemn dhe nga ky moment është antar i Kuvendit të Komunës së Deçanit me të drejta të plota.
Nërsa Fatmir Kurmehaj, i cili ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për arsye të ushtrimit të profesionit si avokat, ju ka drejtuar Kuvendit dhe të tjerëve prezent në mbledhje me një fjalë përshëndetëse, ku në fillim ai ka falenderu te gjith per bashkëpunimin qe ka pase me ta, fillimisht ai falënderon kryesuesin aktual te Kuevendit, z.Haki Shehaj si dhe ish kryesuesin e kuvendit, z.Jashar Dobraj, pastaj falënderon kryetarin e komunës dhe te gjith akteret tjerë per bashkëpunim, do te vazhdoj ta epi kontributin tim edhe jashtë ulëseve te këtij kuvendi ka thene ai ne fund te fjalës se tij.
Kryesuesi- e ka prezentu rendin e ditës.
Mon Selmonaj- fillimisht ka bere vërejtje per mos fapjen e sallës se mbledhjes me kohe, pastaj ka kërkuar sqarim, pse nuk ka ardhe per shqyrtim Raporti i komisionit per objektet sociale, per te cilin jemi dakorduar edhe me kryetarin ka thene ai qe te del ne kete mbledhje pasi qe eshte i gatshëm per shqyrtim.
Kryesuesi- ka thene se vërejtjet janë te drejta, sa i përket raportit te komisionit, eshte e vertete qe jemi dakorduar qe te del ne kete mbledhje nje pjese e raportit mirëpo edhe kjo pjese eshte delikate, por shpresojmë se do ta kemi mbledhjen e radhës.

Shkelzen Hadergjonaj- propozon qe pika nr.6 te debatohet e para sepse eshte ma e rëndësishme.
Mon Selmonaj- thot se jam kundër këtij propozimi edhe vetëm per te njëjtën arsye sepse te gjitha pikat kane rëndësinë e vet, mirëpo edhe se te gjitha pikat para pikës 6 nuk na marrin kohe ma shum se gjysem ore.
Kryesuesi- e qiti ne votim rendin e punës me propozimin qe pika nr.6- Shqyrtimi i Planit Zhvillimor Komunal, te debatohet e para, miratohet rendi i punës si dhe propozimi qe pika nr. 6 te debatohet e para pas procesverbalit.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet njëzëri pa vërejtje.
VI. Shqyrtimi i Planit Zhvillimor Komunal.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj i ka dhene disa sqarime rreth planit te prezentuar, ndërsa per sqarime me detale ia ep fjalën kryetarit te Komunes, z.Bashkim Ramosaj, i cili per te pranishmit ka dhene sqarime fillimisht rreth procedurave te shqyrtimit e pastaj edhe per te gjitha çështjet tjera, ne vazhdim ai ka kërkuar nga asambleistet qe këtij plani tia japin vizën per shqyrtim te mëtutjeshëm, te kapitulli i zhvillimit ekonomik, kryetari ka cekur 15 projektet e mëdha qe i japin zhvillim Deçanit duke sqaruar per çdo njërin veç e veç, pas PZHK-së ka thene kryetari do ti hapet rruga Hartës zonale, ai ka thene se kan mbete pa u përmbyllë edhe pjesa e kanalizimit te ujrave te zeza me buxhet nga niveli qendror, rregullimi i impianteve, rritja e kapacitetit te ujit, projekti i tranzitit i cili e shkarkon qendrën e qytetit, kanalet e ujitjes, ky plan do te hartohet ne harmoni me Planin hapësinorë te Kosovës, ka edhe projekte me bashkëpunim ndërkufitarë, vendbanimet rurale zene vend te rëndësishëm, qasjet ne ndërtesat publike dhe te tjera sepse ky plan do tia bene te mundur zhvillimin e Deçanit si qytet, ai ka thënë se planifikohet qe ne te ardhmen te behet dislokimi i objektit te administratës komunale si dhe i gjykatës, me menagjim te mbeturinave jemi mire ka thene ai, dhe krejt ne fund te përpunimit te këtij plani duhet te rishikohen edhe nje here mire harmonizimi i tij me te gjitha ligjet e Kosovës. Kërkoj ka thene ai qe këtij plani ti epet viza për shqyrtim te mëtutjeshëm ku do te formohen 11 puntori per përpunim te planit ne fusha te caktuara konkrete dhe kërkoj nga ju qe çdo njeri te behet pjese e njërit nga këto punëtori dhe te ep kontributin e vet aty ku e shef veten, Te pjesa narrative e dokumentit duhet te jete e përfshirë funksionimi i tri niveleve te pushtetit edhe pse te ne thuhet se i kemi vetëm dy pushtete mirëpo ne nivelin e mesëm mund te hyjnë Ndermarrjet Publike regjionale.
Albesa Cacaj- thot se plani eshte shum i mire por asgja nuk po shohim ne praktike si pash dokumentet qe miratohen këtu ne kuvend siç janë rregulloret nuk implementohen, edhe këtu ne plan kishte shifra te mëdha marramendëse per projekte, ndërsa ne realitet nuk kemi mjaftueshëm kosha te mbeturinave, ndriçimi publik nuk funksionon mire, projekti i kanalizimit ende nuk ka perfundu, shtrirja e funksionimit te shërbimeve per heqjen e mbeturinave ne tere territorin e komunës ende nuk eshte bere, objektet shkollore kane myk, dhe pyetja ime ne kete rast është , ku do te gjinden mjetet financiare per realizimin e te gjitha këtyre projekteve dhe ne cilat vite do te behet realizimi i tyre.
Kryetari-baza e te gjitha projekteve është PZHK dhe kjo është ëndrra e qytetarëve te Deçanit për një qytet te vetin.
Florim Mataj-thot se ne kete plan janë vu themelet e ndërtimit te Deçanit dhe brenda tij janë përfshi te gjitha, siç janë infrastruktura lokale , infrastruktura zhvillimore, orientimi kah bjeshkët si një aset me rëndësi te veçantë , kurse sa i përket realizimit te tij besoj se do te përmbushet me faza.
Izet Zenuni, drejtor i shërbimeve publike-sqaron se me 15 shtator eshte shtri shërbimi i heqjes se mbeturinave ne një pjesë bukur te madhe te komunes, i kemi hjeke mbeturinat ilegale, ndërsa ne fund te vitit kemi arrite ta shtrijmë shërbimin ne krejt territorin e komunës.
Mon Selmonaj- tha se kryetari ne diskutimin e tij apeloj për dy kërkesa, përfshirja e te gjithë asamblistëve ne grupet punuese qe do te formohen , ku kërkoj qe te na vijnë ftesat me kohe dhe ne do ta japim kontributin tone aq sa mundemi dhe miratimi ne parim, prandaj pres qe te miratohet sot si draft dhe te vazhdojmë me procedura.
Milazim Mushkolaj-thot se është një plan i mire por propozoj qe 6 sektorëve te ju shtohet edhe sektori i shëndetësisë dhe sektori i sigurisë.

Ilir Ferizaj-thot se plani është i mire dhe ambicioz, vërejtje nuk kam, unë ka thënë ai i mbështes projektet ambicioze te propozuara ne bjeshke por duhet te rregullohen edhe projektet ne rrafsh siq eshte kanalizimi ne tersi e projekte tjera.
Kryetari- ka sqaruar për te gjitha çështjet e cekura ne diskutime.
Shkelzen Hadergjonaj –thot se pajtohem me kryetarin për formimin e grupeve punuese dhe çdo njëri nga ne te ep kontributin e vet ne njërin nga grupet.
Erdogan Dautaj-në emër te grupit te AAK-se propozon qe te hedhet ne votim dhe çdo njeri prej nesh ta ep kontributin e vet ne grupin aty ku e shef vehten se eshte ma i nevojshëm.
Kestrim Avdimetaj- kërkon edhe ai qe te qitet ne votim sepse e kemi mundësinë me dhanë kontributin tone te gjithë.
Shkelqim Haxhnikaj- thot se ne Isniq nuk kane ardhe ende te gjitha shportat per mbeturina nga kompania Higjiena.
Kryetari- sqaron se deri ne fund te muajit mars do te behet paisja me shporta te mbeturinave.
Valdet Nuraj-pyet se a ka shprese kete vit qe te behet diçka rreth kanalizimit te ujrave te zeza ne fshatin Strellc.
Kryetari- sqaron se Komuna dhe qeveria e kan krye punën e vet por pritet qe te behet edhe miratimi ne parlament i projektit.
Kryesuesi- e qiti ne votim ne parim Planin Zhvillimor Komunal, antaret e Kuvendit e miratuan njëzëri ate.
II. Marrja e vendimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2019 në vitin 2020.
Kryesuesi- e ka prezentu piken pastaj per sqarime fjalën ia kalon drejtorit te buxhetit i cili per te pranishmit ka dhene sqarime te nevojshme rreth orientimit te hyrave te bartura sipas propozimit te prezentuar.
Kryesuesi- meqenëse nuk kishte diskutime e qiti ne votim propozimin e ekzekutivit, antaret e kuvendit e miratuan njëzëri pa ndryshime.
III. Marrja e vendimit për lejimin e mjeteve buxhetore për aktivitete të Komunës dhe data me rëndësi.
Kryesuesi-e ka prezentu piken dhe ka dhënë disa sqarime rreth saj.
Kryetari i Komunes- ka dhene sqarime te hollsishme per kërkesën ku kërkohet lejimi i mjeteve buxhetore per organizmin e 24 marsit-Epopeja e Dukagjinit, shuma prej 10.000 €, per datat 14 dhe 15 Mars Gara e Skijimit "Kupa e Gjeravicës" kërkohet shuma prej 8.000 €, per datat 5 dhe 6 Maji Dita e Dëshmorëve kërkohet shuma prej 10.000 € dhe per datën 16 Qershor për ndere te Çlirimit te Deçanit dhe mbajtjes se Festivalit "Eshkë e ndezur mbi Shkelzen" shuma prej 10.000 €.
Shkelzen Hadergjonaj-ka thene se meqë Dita e Dëshmorëve me dt.5 dhe 6 maj eshte hera e pare qe organizohet këtë vit për te gjithë dëshmorët do ta shohim se si do te shkon mirëpo kishte qene mire qe te formohet një komision për te, ndërsa për Bjeshke te Belegut ku do te mbahet gara e Gjeravices propozoj qe brenda mundësive tona te marrim një vendim qe mos te degradohet ambienti aty me ndërtimin e tbaneve(staneve) pa kriter aty.
Kryesuesi- sqaron se kjo është diçka pozitive edhe sepse aty është një vend qe joshe investitorët e huaj dhe çdo ndryshim pozitiv është ne interes tone.
Ilir Ferizaj- thot se propozimi për ndarjen e mjeteve për datat e caktuara është e qëlluar por kërkoj nga Kuvendi qe te ndanë edhe një shume te caktuar për pajisjen e Ansamblit te Këngëve dhe valleve me gardërobë.
Drejtori i buxhetit- pajtohet me kërkesën për pajisje te anëtareve te ansamblit me gardërobë dhe kërkon qe te vjen një liste me numrat qe duhet ti kenë veshjet si dhe me sasinë sa nevojiten.
Ilir Ferizaj thot se duhet te pajisen se paku 12 qifte me gardërobë, mirëpo pas debatit te zhvilluar u pa e nevojshme qe te pajisen 15 qifte me gardërobë, kurse procedurat te zhvillohen përmes zyrës se prokurimit.
Albesa Cacaj-thot se nuk është bere një analize e mire kur është bere ky propozim, ndërsa edhe përkundër ngritjes se çështjes se ndarjes se bursave për student një gjë e tille nuk është bere me arsyetimin se nuk ka buxhet.
Kryetari- thot se do ti shiqojme mundësitë buxhetore kete vit.

Lirije Zukaj- pyet a ka kushte per mbajtjen e garës Kupa e Gjeravices, dhe propozoj qe te mbahet nje takim me banoret e fshatrave :Beleg, Kodrali dhe Pozharë , te cilët kane pjese ne atë bjeshke dhe te ju sqarohet çdo gjë qe po behet aty.
Valdet Nuraj- thot se shumat e propozuara për këto aktivitete janë shum pak dhe pyet se a na përkrahë edhe neve Ministria sikur Festivalet tjera qe mbahen ne Kosove.
Kryesuesi-e qiti ne votim propozimin ashtu si ka ardhe pa ndryshime, anëtarët e kuvendit e miratojnë me dy abstenime.
Kryesuesi- e qiti ne votim propozimin për pajisjen e ansamblit te valleve me gardërobë për 15 qifte, anëtarët e kuvendit e miratojnë njëzëri ate, e cila do te behet me procedure te prokurimit.
IV. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për Shërbime Publike.
Izet Zenuni, drejtor i Sherbimeve publike ka sqaruar rreth projekt rregullores se propozuar.
Albesa Cacaj- thot se rregullorja eshte copy paste.
Kryetari- sqaron se projekt rregullorja është draft i Asociacionit te Komunave te Kosovës, i punuar nga ekspertet nga tere Kosova.
Drejtori i Sherbimeve Publike- thot se si material ju ka përshtatë 90 % nevojave te komunës sonë.
Milazim Mushkolaj-kerkon qe te bëhen konkret propozimet për ndryshimin e pikave te caktuara ne draft rregullore.
Erdogan Dautaj- propozon qe te votohen bashke dhe te dalin ne diskutim publik Projekt Rregullorja per shërbime publike dhe teksti i projekt- rregullores Për Lartësinë e Taksave, Ngarkesave,Tarifave dhe Gjobave Komunale, me arsyetimin se te dyja janë drafte te propozuara nga Asociacioni i Komunave te Kosovës.
Kryesuesi- i qiti ne votim dy projket rregulloret: 1. Projekt Rregulloren për Shërbime Publike dhe 2.Projekt Rregulloren për taksat komunale, anëtarët e Kuvendit njëzëri i miratuan ne parim dy projekt rregulloret dhe si te tilla ne procedure te mëtutjeshme dalin e diskutim publik.
VII. Shqyrtimi i Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Komunën e Deçanit 2019-2022.
Kryesuesi- e prezantoj piken dhe e hapi debatin rreth saj, mirëpo meqenëse nuk kishte diskutime ai e qiti ne votim, anëtarët e kuvendit e miratuan njëzëri atë pa ndryshime.
VIII.Ndryshimi dhe plotësimi i KPF-se.
Albesa Cacaj e zëvendëson ne KPF Fatmir Kurmehaj, i cili ka dhënë dorëheqje, dhe vjen nga i njëjti subjekt politik LDK.
IX. Te ndryshme.
Kryetari- ka prezentu kërkesën për ndërtimin e Qendrës Turistike në bjeshkën e Belegut, i cili shkon në interes të zbatimit të projektit me bashkëpunim ndërkufitarë në mes të Komunës së Deçanit dhe Komunës së Andrijevicës të Malit të Zi, që në theks të veçantë ka të bëjë me zhvillimin e Turizmit në Komunën e Deçanit.
Kryesuesi- e qiti ne votim, antaret e kuvendit e miratojnë njëzëri.
Ilir Ferizaj- ka ngrite çështjen e gurthyesve për te cilin është një kundërshtim i banorëve te dy fshatrave, Llukë e Ulet dhe dhe Lluke e Eperme.
Kryetari- njofton për ato zhvillime si dhe per angazhimin e tij ne kete drejtim, per te cilin thot ai ju kam sugjeruar banorëve qe rastin ta qojnë ne Prokurori te shtetit.
-Mehmet Osaj- kërkon raport për 21% te objektit te banesa e kuqe, ka ngrite qeshtjen e urave te ndërtuara per te cilat sipas tij thonë se janë ndertu keq, kërkon sqarim sa kemi perfitur nga shfrytëzimi i zhavorrit nga kompanitë, kurse per bjeshke thot ai se çdo kush e shfrytëzon bjeshkën sipas te drejtës zakonore.
Kryetari- ka sqaruar per shfrytëzim te zhavorrit, ai ka thënë se kompania qe po e ndërton rrugën do te furnizohet edhe me zhavorr.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse:Dyke Llolluni

Verifikon procesverbalin:

Kryesuesi i Kuvendit:
Haki Shehaj